




Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës



Drejtoria për Administratë dhe Personel

Zyra e Prokurimit

Nr 03/ 18

Datë 27/05 2020

KONTRATË PROKURIMI Nr 10

Komuna e Malishevës (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe
„LEDIONI GROUP” SHPK me seli në Suharekë me Nr biznesi 811561308 (në vazhdim
"Operatori Ekonomik"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

SANIMI I URËS QË LIDHË FSHATIN BUBËL -SFERKË

me numër identifikues 62500.21.031.536

Neni 1

Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **SANIMI I URËS QË LIDHË FSHATIN BUBËL -SFERKË**
- 1.2 Kontrata hynë në fuqi me rastin e nënshkrimit dhe përfundon me kryerjen sanimit të urës që lidhë fshatin Bubël -Sferkë.
- 1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se [shëno numrin] ditë nga data e marrjes së urdhërësës.
- 1.4 Vendi i kryerjes së sanimit të urës do të jetë : në fshatin Bubël .
- 1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2

Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-04/L-042 dhe ligji Nr 05/068. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 ÇMIMI

3.1 Çmimi total i kontratës është : 7,136.00€ (me shkronja) :
(shtatëmijënjëqindëetridhjetëegjashtëeuro) Euro.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës.

Neni 3.3 Menaxhimi i Kontratës

Menaxhimi i Kontratës do ta bëjë zyrtari i Urbanizmit z.Mehdi Krasniqi i caktuar nga ZKA i AK .

Menaxheri i kontrates është përgjegjës për mbikqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës ,duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti kontraktues.

Menaxheri i kontrates do të mbikqyrë OE gjatë tërë kohës sa zgjasin punimet duke filluar nga dita e parë e fillimit të punimeve e deri në përfundimin e kontratës përkatesisht ekzekutimin e kontrates.

Qëllimi i mbikqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe sasinë e materialeve dhe cilësinë e tyre.

AK e ruan të drejtën që t'ia ndërprej kontratën me OE për mos realizimin e kontrates në cilësi dhe afatë dhe në përputhje të plotë me specifikacionin e ofertes .

Neni 3.4. Fillimi i punëve

Punimet do të fillojnë brenda pesë (5) ditësh që nga dita e nënshkrimit të kontratës por mund të fillojnë edhe më herët nëse OE është i përgatitur. Kjo vërtetohet në raportin e menaxherit të projektit.

Neni 3.4.Obligimet e OE

OE është i obliguar që sanimin e urës që lidhë fshatin Bubël -Sferkë, ta kryej në përputhshmeri të plotë me specifikacionin e ofertes.

Sanimi i urës që lidhë fshatin Bubël -Sferkë duhet të kryhet në cilësi dhe sasi të kërkuar nga AK.

Nëse Sanimi i urës që lidhë fshatin Bubël -Sferkë nuk kryhet në cilësi dhe sasi të kërkuar nga AK dhe në përputhshmeri me specifikacionin e ofertes shpenzimet e bera biejnë në llogari të operatorit ekonomik. OE nuk do të pranohet edhe punët e kryera pa porosi të AK. Kontraktuesi i parë (AK) e ruan të drejtën që t'ia ndërprej kontratën me kontraktuesin e dytë (OE) për mos realizimin e kontratës në cilësi dhe afatë .

Neni 3.5. Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

Kontraktuesi (OE) i bartë të gjitha rreziqet që mund të ndodhin gjatë kryerjes së punimeve si lëndime personale, vdekje, humbje të pasurisë përfshirë pa kufizime të gjithë pasurinë si dhe rreziqe tjera që mund të ndodhin gjatë kryerjes së punëve që kanë të bëjnë me këtë kontratë.

Neni 3.6. **AFATI**

Sanimi i urës që lidhë fshatin Bubël -Sferkë do të kryhet brenda tridhjetë (30) ditësh që nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Neni 4 **PAGESA**

4.1. Pagesa do të bëhet në Euro.

4.2. Obligohet kontraktuesi i parë (AK) që pasi t'a pranon raportin e kryerjes së Sanimi i urës që lidhë fshatin Bubël -Sferkë nga zyrtari perkates dhe faturën nga kontraktuesi (OE) t'ia paguaj shumën sipas nen. 3 dhe 3.1 të kësaj kontrate (pagesa kontraktuesit do të i bëhet në bazë të raportit të zyrtarit të caktuar nga ZKA i AK për menaxhim të kontratës).

4.3. Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

4.4. Pranimi teknik i punimeve

Pranimi teknik i punimeve do të bëhet nga një komision i caktuar nga ZKA i AK mbas perfundimit të punimeve.

4.5. Pranimi perfundimtar i Punimeve

Pranimi perfundimtar i punimeve do të bëhet nga një komision i caktuar nga ZKA i AK mbas kalimit të periudhës prej 12 muaj nga dita e pranimit teknik të punimeve.

Neni 5 **Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 **Kualiteti**

6.1 Kualiteti i punimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 **Garancioni**

7.1. Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit teknik të puneve, nese gjate periudhes se garancionit te punimeve shfaqen defekte te punimeve OE eshte i obliguar qe te bej permisimin e punimeve. Nese OE nuk e ben permisimin e punimeve do te merren masa ne perputhje te plote me LPP ne fuqi.

Neni 8 **Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i kryej ndonjë ose të gjitha punet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,05%] në ditë, të vlerës së punëve të pa dorëzuara/realizuar deri në një maksimum prej [10 %] të vlerës totale të kontratës dhe NDALESEN ESHTË I OBLIGUAR TA E BEJ MENAXHERI I PROJEKTIT gjate pergatitjes se raportit per pranim te punimeve.

Neni 9 **Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 **Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 ***Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues***

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12

Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [specifiko gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin e Kosovës.


Neni 14

Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.
E hartuar në gjuhën **Shqipe** në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Nuhi Shalaj	Emri:	Lendita Kryeziu
Pozita:	Menaxher i Prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	26.05/21	Data:	
Vula:		Vula:	

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

Projekti: SANIMI I URËS QË LIDHË FSHATIN BUBËL - SFERRK

Nr.	Pozicioni	Njësia	Sasia	Çmimi njësi €	Çmimi total €
A PUNET PERGATITORE					
A.1	Ingjizimi i terenit si dhe përcjellja e punimeve gjeodezike gjatë ekzekutimit	Cope	1.00	20.00	20.00 €
A.2	Furnizimi dhe montimi i tabelës informuese mbi projektin me dimensione 160x100 cm	Cope	1.00	20.00	20.00 €
A.3	Pastrimi i punishtës nga shkurret dhe drunjet e ndryshëm, bartja e materialit deri në deponi me se largu 5 km	m'	30.00	0.50	15.00 €
A.4	Pastrimi i punishtës pas përfundimit të punimeve	Cope	1.00	20.00	20.00 €
Gjithsej A:					75.00 €
B PUNET DEMOLUESE					
B.1	Demolimi i murit nga guret dhe bartja e materialit në distancë me se largu 5 km	m'	10.00	2.00	20.00 €
B.2	Demolimi i murit nga beton armë me mjete adekuate dhe bartja e materialit deri në deponi në distancë me se largu deri 5 km	m'	20.00	3.00	60.00 €
Gjithsej B:					80.00 €
C PUNËT TOKËSORE					
C.1	Germimi i dheut të kat. VII & VIII, me makinë dhe mjete tjera adekuate (Pikometer), material i germuar të përdoret për mbushjen dhe rrafshimin e sipërfaqes.	m³	70.00	1.00	70.00 €
C.2	Germimi i dheut të kat. III & IV me makinë dhe mjete tjera adekuate (Pikometer) për hapjen e themeleve shiritore të mureve mbajtëse material i germuar të përdoret për mbushjen dhe rrafshimin e sipërfaqes.	m³	40.00	1.00	40.00 €
C.3	Sigurimi i gropës ndërtimore nga rrëshqitja e terrenit si dhe vendosja e shenjave të sigurisë konform normave ndërtimore në fuqi	m'	30.00	1.00	30.00 €
Gjithsej C:					140.00 €
D PUNËT E MBUSHJES					
D.1	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit 0-63mm nën bazën e themelit me trashësi t=10 cm me ngjeshmeri 50MN/m²	m³	7.00	7.00	49.00 €
D.2	Furnizimi dhe mbushja mbraja mureve me zhavorr drenazhues fraksion 8-63 mm me ngjeshje në shtresa	m³	22.00	7.00	154.00 €
D.3	Furnizimi dhe montimi i gypit të dreazhit PVC Ø125 mm prapa murit, pozicioni parashihet edhe mbështjelljen e tij me folie gjeotekstili	m'	35.00	2.50	87.50 €
D.4	Furnizimi dhe montimi i gypit të dreazhit PVC Ø50 mm normal me murin,	Cope	60.00	1.00	60.00 €
Gjithsej D:					350.50 €
E PUNËT E BETONIT					
E.1	Furnizimi, transporti dhe betonimi i themelit dhe murit të mureve mbajtëse nga betoni i armuar C25/30, në çmim të llogaritës vendosja e pahive, fugat e dilatimit në çdo 12 m, dhe mirmbajtja e betonit. Sipërfaqja e betonit duhet të jetë e lëmuar dhe pa sgragime, sipas detalit të dhënë.	m³	49.50	70.00	3,465.00 €
Gjithsej E:					3,465.00 €
F PUNËT E ARMATURËS					
F.1	Furnizimi, transporti, lakimi dhe montimi i armaturës së brinjëzuar S-500 MPa për themele dhe murin mbrojtës. Sipas detalit të dhënë. Ø=8 mm Ø=10 mm Ø=12 mm Ø=16 mm Llogaria në kg	kg	2,958.00	0.8	2,366.40 €
Gjithsej F:					2,366.40 €



G PUNET TJERA					
G.1	Furnizimi dhe punimi i lëshesave me gypa të betonit të armuar me trashësi të mureve $t=10$ cm dhe me diameter të gypit $\varnothing 1000$ mm. Distanca minimale nga skaji i trases së rruges $l=1.0$ m' (kokat hyrse dhe dalje)	m'	6.00	65.00	390.00 €
G.2	Furnizimi dhe punimi i lëshesave me gypa të betonit të armuar me trashësi të mureve $t=10$ cm dhe me diameter të gypit $\varnothing 800$ mm. Distanca minimale nga skaji i trases së rruges $l=1.0$ m' (kokat hyrse dhe dalje)	m'	4.00	55.00	220.00 €
G.3	Furnizimi me material dhe betonimi i sipërfaqes së betonit me trashësi $t=15$ cm. në flogari hyn edhe rrjeta e armatures Q-335 ($\varnothing 10/15/15$)	m ²	10.00	5.00	50.00 €
REKAPITULLIMI					Gjithsej E:
A PUNET PERGATITORE					660.00 €
B PUNET DEMOLUESE					75.00 €
C PUNET TOKËSORE					80.00 €
D PUNET E MBUSHJES					140.00 €
E PUNET E BETONIT					350.50 €
F PUNET E ARMATURES					3,465.00 €
G PUNET TJERA					2,366.40 €
					660.00 €
					Gjithsej: 7,136.90 €

